



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Raport nga pjesëmarrja e publikut në identifikimin e problemeve në 5 PRRU në Komunën e Prishtinës

Prishtina e Re, Mati 1, Qyteza Pejton, Qendra 1
dhe Tophane

Prishtinë
09/07/2015



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

**CH
WB**
Cultural
Heritage without Borders
KULTURNY UČAN GRANICE

Përmbajtja

Parathënie.....	2
Lista e shkurtesave	3
Prishtina e Re	4
Mati 1	6
Pejton – Rezultatet e Punëtorive	8
Qendra 1.....	10
Tophane	12
Foto nga takimet me GKK-në	14
Foto nga prezantimi i rezultateve te hulumtimit para GKK-së	14
Raportimi në media të shkruara	15
Foto nga hulumtimet ne terren.....	17
Aneksi 1.....	18
Prishtina e Re – Rezultatet e Punëtorisë.....	18
Aneksi 2.....	23
Mati 1 - Rezultatet e Punëtorisë	23
Aneksi 3.....	27
Qyteza Pejton – Rezultatet e Punëtorisë -	27
Kërkesat Individuale.....	Error! Bookmark not defined.
Aneksi 4.....	32
Qendra 1 dhe 2 – Rezultatet e Punëtorisë	32
Aneksi 5.....	36
Tophane – Rezultatet e Punëtorisë	36
Konkluzione.....	42
Rekomandime në proces të rishikimit të planeve	42
Rekomandime të përgjithshme.....	42

Parathënie

Ky raport prezanton rezultatet e një procesi të diskutimit me palë të ndryshme të interesit në lidhje me identifikimin e problemeve kyçe në pesë plane rregulluese në Prishtinë. Planet rregulluese të identifikuar nga komuna e Prishtinës gjegjësisht Drejtoria e Urbanizmit Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit (DUNMM) si më sfiduese gjatë implementimit të tyre janë: Prishtina e Re-Zona Perëndim, Mati 1, Qyteza Pejton, Qendra 1 dhe Tophane. Ky proces ka filluar në Janar 2015 dhe diskutimet me palë të interesit përfunduan në fund të Qershorit 2015. Raporti paraqet punën e përbashkët të të gjitha palëve të interesit të përfshira si: DUNMM e Komunës Prishtinës, Grupi Këshillues i Komunitetit (GKK), Ekipi i Planerëve të projektit "Promovimi i pjesëmarrjes aktive në planifikim hapësinor në nivelin lokal" i implementuar nga Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHwB) dhe financuar nga USAID, dhe qytetarët në përgjithësi. Gjatë kësaj kohe janë përfshirë më shumë se 1500 persona gjatë punës në terren dhe punëtori të ndryshme të organizuar me qëllim të identifikimit të këtyre problemeve.

Gjatë këtij 6 mujori janë mbajtur 4 takime me GKK-në, ku bashkërisht është hartuar Plani i Pjesëmarrjes së Publikut (PPP)-annex6, është implementuar një anketë në terren me qëllim të përmbledhjes së një opinioni të përgjithshëm rreth informimit dhe problemeve kryesore në 5 PRRU rezultatet e të cilit janë prezantuar në Maj 2015. Punëtoritë me palët e interesit janë organizuar gjate muajve Maj dhe Qershor 2015.

Mund të thuhet që ishte një proces dinamik, ku palët e interesit iu përgjigjen me entuziazëm aktiviteteve, takimeve/punëtorive të organizuara për secilën PRRU veç e veç. Vlen të theksohet që ky proces ka patur vëmendjen e mediave, posaçërisht gjatë punëtorive për identifikimin e problemeve kyçe të organizuara për secilën PRRU.

Ky raport ka 4 objektiva kryesore:

- Prezantimin e problemeve kryesore të cilat janë identifikuar gjatë punëtorive të organizuara me komunitetin e zonës;
- Prezantimin e sfidave kryesore për implmentimin e PRRU-ve nga ana e autoriteteve komunale;
- Prezantimin e rezultateve të pyetësorit të implementuar në terren për identifikimin e problemeve nga publiku i gjerë;
- Të shërbejë si pikënisje për revidimin e PRRU-ve nga ana e komunës si dhe inkorporimin e tyre në hartën zonale të planit zhvillimor komunal të komunës së Prishtinës;

Ky raport dhe i gjithë procesi nuk përbën një konkuldim, po një fillim i cili do të ndihmojë autoritetet komunale në qartësimin dhe konkretizimin e problemeve, si dhe lokalizimin e tyre në terren. E gjithë kjo do të lehtësojë procesin e ballafaqimit me këto sfida , si dhe do të shërbejë në përmirësimin e komunikimit të autoriteteve komunale me qytetarë.

Raporti përbëhet prej 3 pjesëve:

1. Përmbledhje e rezultateve të procesit
2. Rezultatet e punës grupore
 - Rezultatet individuale
 - Prezantimi i problemeve në hartë

Lista e shkurtesave

CHwB - Cultural Heritage without Borders – Trashëgimia Kulturore pa Kufij

DUNMM-Drejtoria e Urbanizmit Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit

HZK – Harta Zonale Komunale

MMPH – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

PPP – Plani i Pjesëmarrjes së Publikut

PRRU-Plani Rregullues Urban

PZHU-Plani Zhvillimor Urban

USAID – Agjensioni Amerikan për Zhvillim ndërkombëtar

Prishtina e Re

Sfondi

Plani Rregullues Urban (PRRU) për lagjen Prishtina e Re është aprovuar në Shtator të vitit 2013. Siapas drejtorisë së urbanizimit ndërtimit dhe mbrojtjes së mjedisit në komunën (DUNMM) e Prishtinës, procesi i implementimit të planit është mjaft sfidues.

Në takimet e mbajtura me Grupin këshillues të komunitet, kjo zonë ka qenë e përfaqësuar nga kryetari i bashkësisë lokale dhe anëtarë tjerë të kryesisë të cilët kanë adresuar të gjitha çështjet të cilat kanë penguar implementimin e këtij plani. Të gjitha palët e interesit janë identifikuar në bashkëpunim të ngushtë me përfaqësuesit e lagjes dhe në punëtorinë e organizuar me 24 Maj 2015, kanë marrë pjesë 76 përfaqësues të komunitetit, ku janë identifikuar dhe janë lokalizuar në hartë të gjitha çështjet kyçe ku sipas komunitetit kanë pamundësuar implementimin e PRRU-së sitë tillë. Të gjithë të pranishmit në takim kanë demonstruar një vullnet për bashkëpunim me komunën, si dhe në raste të caktuara kanë qenë të gatshëm të ofrojnë edhe zgjedhje rreth problemeve të caktuara.

Përmbledhje - Rezultatet e pjesëmarrjes

Gjatë diskutimit dhe punës me palë të interesit në punëtori, është theksuar mjaft çështja e informimit dhe komunikimit të autoriteteve komunale me banorët dhe publikun e gjerë të zonës. Kjo çështje është vërtetuar edhe nga banorët në përgjithësi me anë të anketës e cila është implementuar në terren gjatë muajit Prill 2015, ku ka dalë që vetëm 2% nga të anketuarit ku gjithsej kanë qenë 399, kanë qenë të informuar për PRRU-në gjatë kohës së hartimit të tij.



Puna në grupe në punëtorinë e mbajtur për PRRU-në Prishtina e Re-Zona Perëndim

Çështjet kyçe të identifikuar nga ana e pronarëve/banorëve si pengesë në lidhje me implementimin e PRRU-së janë: mos respektimi i gjendjes ekzistuese gjatë hartimit të planit

(parcelizimi, rrugët, infrastruktura në përgjithësi). Plani në përgjithësi injoron shumë objekte ekzistuese (disa me leje ndërtimi), duke planifikuar në ato hapësira përmbajtje tjera.

Qytetarët janë shprehur që sipas planit, shërbimet publike dhe infrastruktura sociale është planifikuar në toka private të cilat kanë qenë veçse të parcializuara, ku infrastruktura përcjellëse për banim ka qenë e ndërtuar para se ky plan të aprovet. Ndërrimi i destinimit i pronave private të planifikuara me destinim publik si çerdhe shkollë e ambulance, dhe dhënia e mundësisë së ndërtimit pronarëve privat për ndërtim, ka dalë si një nda çështjet kryesore dhe prioritare për shume banorë dhe e cila kërkon trajtim urgjent. Gjithashtu, vendosja këtyre përmbajtjeve në prona komunale, publike apo edhe shoqërore është parë prioritet nga ana e qytetarëve. E gjithë zona që ka sipërfaqe të konsiderueshme i mungojnë përmbajtjet publike si shkollë, çerdhe e ambulante. Bazuar në diskutime dhe prezantime shumë prona komunale e shoqërore janë të uzurpuara nga individë të ndryshëm dhe lirimi këtyre pronave do të krijonte hapësirë të mjaftueshme për gjelbërim dhe hapësira me destinim publik.



Prezantimet e problemeve nga ana e përfaqësuesve të komunitetit

Në detaje të gjitha këto çështje janë prezantuar në prani të përfaqësuesve të lagjeve dhe të lokalizuara në hartë. Të gjitha çështjet e identifikuar dhe të prezantuara kanë gjetur pajtueshmëri tek të gjithë përfaqësuesit të pranishëm në punëtori dhe nuk ka patur asnjë kundërshtim. Për rezultatet e punës grupore dhe lokalizimi i problemeve në hartë referojuni Aneksit -1.

Mati 1

Sfondi

Plani Rregullues Urban (PRRU) për lagjen Mati 1 është aprovuar në Mars të vitit 2010. Sipas drejtorisë së urbanizimit ndërtimit dhe mbrojtjes së mjedisit (DUNMM) në komunën e Prishtinës, procesi i implementimit të planit edhe pse tashmë 5 vite i aprovuar është treguar mjaft sfidues.

Në takimet e mbajtura me Grupin këshillues të komunitet, kjo zonë ka qenë e përfaqësuar nga kryetari i bashkësisë lokale dhe përfaqësues tjerë të zonës të cilët kanë adresuar disa nga çështjet më sfiduese të implementimit të këtij plani. Të gjitha palët e interesit janë identifikuar në bashkëpunim të ngushtë me përfaqësuesit e lagjes dhe në punëtorinë e organizuar me 04 Qershor 2015 në shkollën fillore "Pavarësia" në zonën e PRRU-së, kanë marrë pjesë 46 përfaqësues të komunitetit përfshirë këtu: banorë, pronarë tokash, investitorë aktual dhe potencial etj., si dhe ekipi i fasilituesve të projektit dhe zyrtarët komunal. Në këtë takim janë identifikuar dhe janë lokalizuar në hartë të gjitha problemet nga ana e komunitetit kanë pamundësuar implementimin e PRRU-së sitë tillë. Në hulumtimin në terren ku janë përgjigjur pozitivisht anketës 444 qytetarët e zonës Mati 1, ka dalë që vetëm 3% të qytetarëve kanë qenë të informuar gjatë hartimit të PRRU-së dhe se vetëm 9% janë në dijeni me përmbajtjen e PRRU-së.

Përmbledhje - Rezultatet e pjesëmarrjes

Kryesisht në Matin 1 problemet kanë derivuar si rezultat ku implementimi i planit nuk është menaxhuar me të gjitha palët e interesit njëkohësisht dhe sistematikisht. Gjithashtu Mati 1 një ka një diskrepancë të theksuar në mes të Planit Zhvillimor Urban (PZHU) dhe Planit Rregullues Urban (PRRU) ku në zona të caktuara PZHU nuk e merr parasysh atë që është e planifikuar me PRRU, pasi që PZHU është aprovuar në 2013. Kjo u theksua edhe nga DUNMM-ja në prezantimin e shfaqit sfidat rreth zbatimit të kësaj PRRU-je siç janë: realizimi i infrastrukturës në përgjithësi, ndërtimet pa leje, përmbushja e nevojave me institucione arsimore, hapësira rekreative-hapësira publike.

Ankesa kryesore ka qene se me PZHU në shumë zona është ulur koeficienti i ndërtimit dhe bazuar në komunitet ky plan nuk i ka trajtuar të barabartë të gjitha palët e interesit, gjë e cila është një nga parimet kryesore në plan. Sipas komunitetit në zonën e PRRU-së Mati 1, shumë çështje të identifikuar kanë të bëjnë me shërbimet publike (rrugë, ndriçim, shkollë, çerdhe etj) dhe me menaxhim urban ku shumë pjesë të lagjes/parcela të vogla të cilat nuk janë trajtuar apo nuk janë marrë parasysh në rastet kurë janë implementuar projekte te mëdha zakonisht ato te banimit. Pra, mos përfshirja e parcelave të vogla në zgjedhjet urbane është një ndër çështjet kryesore të identifikuar, gjë e cila ka pamundësuar jetë normale të banorëve në këto pjesë. Është kërkuar zgjedhje urgjente për raste të tilla. Gjithashtu, nga ana e investitorëve

janë ngritur çështjet rreth hapësirës termoizoluese të objekteve, ku kërkohet që kjo hapësirë të mos llogaritet në totalin e përgjithshëm të hapësirës ndërtuese.



Puna në grupë në punëtorinë e mbajtur për identifikimin e problemeve në PRRU-në Mati 1

Vlen të theksohet që është ngritur edhe çështja e validitetit të PZHU-së, pasi që PZHU është aprovuar pasi që Ligji i Planifikimit Hapësinor Nr.04/L-174, dhe sipas banorëve pasi që ky plan nuk parashihet në legjislacionin aktual, duhet të shfuqizohet. Kërkesa për sqarim rreth validitetit të PZHU-së, qytetarët e kësaj zone i kanë dërguar edhe në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ku nuk kanë marrë përgjigje.



Prezantimi i sfidave gjatë implementimit të PRRU-së nga ana e DUNMM-së

Prezantimi i problemeve nga ana e qytetarëve

Në detaje të gjitha këto çështje janë prezantuar dhe diskutuar në prani të përfaqësuesve të lagjeve dhe të lokalizuara në hartë. Të gjitha çështjet e identifikuara dhe të prezantuara kanë gjetur pajtueshmëri tek të gjithë përfaqësuesit të pranishëm në punëtori dhe nuk ka patur asnjë kundërshtim. Për rezultatet e punës grupore dhe lokalizimi i problemeve në hartë referojuni Annexit -3.

Pejton – Rezultatet e Punëtorive

Sfondi

Plani Rregullues Urban "Qyteza Pejon", është aprovuar në Janar të vitit 2011, procesi i implementimit të këtij plani është treguar të jetë mjaft sfidues duke rezultuar në lëshimin e vetën dy lejeve ndërtimore sipas DUNMM-së nga 2011-2015, dhe duke patur 300 kërkesa për legalizim në këtë zonë. Kjo jep indikacion për kompleksitetin e situatës së kësaj PRRU-je. Në grupin e GKK-së kjo zonë ka qenë e përfaqësuar nga kryetari i bashkësisë lokale, si dhe problemet kryesore janë diskutuar në takime mbajtura me autoritetet komunale. Gjithashtu, në anketimin në terren iu kanë përgjigjur pozitivisht anketës 105 respondentë ku është cekur që 19% të të gjithë të anketuarve janë në dijeni në lidhje me përmbajtjen e PRRU-së, ndërsa gjatë hartimit të këtij plani kanë qenë të informuar 27% nga të gjithë të anketuarit.

Përmbledhje – rezultatet e pjesëmarrjes nga punëtoritë

Punëtorja për identifikimin e problemeve kyçe në PRRU-ne "Pejton" është mbajtur me 09 Qershor, 2015 në hotelin "Prishtina" në zonën e PRRU-së. Problemet e identifikuara në këtë zonë kanë të bëjnë me çështje të menxhimit urban dhe me atë të shërbimeve publike. Nga ana e komunës janë prezantuar çështjet kryesore që mbesin sfidë për realizimin e PRRU-së siç janë: Realizimi-Zhvillimi i një blloku urban, realizimi i infrastrukturës në përgjithësi, ndërtimet pa leje, përmbushja e nevojave me institucione arsimore, hapësira rekreative-hapësira publike. Gjithashtu, PZHU nuk është harmonizuar me PRRU-ne dhe kjo vështirëson procesin e implementimit dhe dhënies së lejeve nga ana e autoriteteve komunale.



Prezantimi i sfidave gjatë implementimit të PRRU-së nga ana e DUNMM-së



Puna në grupe

Bashkimi i parcelave për realizimin e një blloku urban bazuar në PRRU, gjë e cila pengohet nga ndërtimet pa leje të cilat janë ekzistuese, ka dalë si një nga problemet kryesor që pengojnë implementimin e planit.



Prezantimi i problemeve nga ana e qytetarëve

Shkolla, çerdhja me objektet e tyre ekzistuese janë çështje të cilat u diskutuan për arsyet që këto institucione janë të mbipopulluara nga nxënësit të cilët janë jashtë zonës së Pejtonit. Është kërkuar nga autoritetet komunale të u jepet prioritet fëmijëve banorë të zonës për regjistrimin në çerdhe/kopsht dhe shkollë. Çështja e parkingjeve gjithashtu është diskutuar gjerësisht, problem i cili është identifikuar si kryesor edhe nga banorët nëpër gjithësi gjatë anketës së implementuar në Prill. Është kërkuar që parkingjet të planifikohen në hapësira publike jo në ato private.

Çështja e shërbimeve publike si infrastrukturë teknike është diskutuar shumë, pasi që ujësjellësi dhe kanalizimi ekzistues nuk i përgjigjën objekteve me etazhitet të lartë të ndërtuar posaçërisht në aksin e rrugës "Luan Hardinaj". Gjithashtu edhe është diskutuar për bizneset hoteliere/kafenetë zhurma e të cilave dëgjohet edhe pas mesnate kërkohet të respektohet orari i punës deri në 23:00.

Në lagjen "Ramiz Sadiku" si pjesë e PRRU-së "Pejton", janë identifikuar problemet pronësore ku banorët të cilët jetojnë në këtë zonë kanë të privatizuar shtëpitë/objektet, por jo tokën në të cilën gjendet objekti. Kjo ka pamundësuar rregullimin/renovimin e këtyre objekteve me qëllim të spërmirësimit të kushteve të jetës. Në këtë lagje gjithashtu mungon infrastruktura elementare si ujësjellës, kanalizim, ndriçim etj. Gjithashtu në këtë lagje mungon edhe infrastruktura elementare siç janë rrugët, ndriçimi, si dhe infrastruktura teknike. Kërkohet të bëhet një zgjedhje sa më e shpejtë në këtë lagje pasi që si e tillë nuk ofron kushte normale të banimit.

Është vërejtur që gjatë diskutimit me përfaqësuesit të lagjes Pejton, është humbur durimi nga pritjet e shumta, ngase shume pronarë tokash presin zgjidhje me vite që pas aprovimit të PRRU-së.

Qendra 1

Sfondi

Plani rregullues urban (PRRU) i hartuar për zonën Qendra 1 gjithashtu është identifikuar nga ana e komunës si sfidues në implementim. Gjatë takimeve me GKK-ë kjo zonë është përfaqësuar nga kryetari i bashkësisë lokale dhe shumë çështje rreth zonës së qendrës janë diskutuar nga të gjithë anëtarët e GKK-së. Ashtu si edhe me planet tjera PRRU Qendra 1 nuk është në harmoni me PZHUU-në e cila është aprovuar me 2013. PRRU për Qendrën 1 është aprovuar në vitin 2005 dhe që nga ajo kohë janë lëshuar 20 leje ndërtimi, 50 janë refuzuar dhe 5 janë në procedurë. Krahasuar me kohën kurë është aprovuar ky plan dhe zhvillimin goxha të hovshëm të kësaj zone, kjo rezulton në një përqindje shumë të ulët të implementimit të planit ashtu siç është planifikuar. Sfidat kryesore të identifikuar nga ana e DUNMM-së: janë mungesa e tokës komunale, parcelat e vogla, realizimi i rrugëve nëntokësore të planifikuara me plan, ndërtimet pa leje, realizimi i garazheve nëntokësore, përmbushja e nevojave me institucione arsimore.

Sipas hulumtimit në terren ku janë përgjigjur 123 qytetar, ka rezultuar që gjatë hartimit të këtij plani kanë qenë të informuar 35% të qytetarëve në këtë zonë, gjithashtu rreth 20% ka dalë që janë në dijeni me përmbajtjen e kësaj PRRU-je.

Rezultatet e pjesëmarrjes

Punëtorja për PRRU Qendra 1 u mbajt më 23 qershor, në afërsi të zonës dhe u përfaqësua nga 47 të pranishëm palë të ndryshme të interesit. Sipas banorëve ky plan është i pamundur të realizohet në mënyrë të planifikuar për shkak që prekë shumë objekte të cilat tashmë kanë vlerë të madhe kapitale dhe janë to kontraktura nga kompani të mëdha të cilat operojnë në zonë. Pasi që kjo zonë është më interes të lartë administrativ the ekonomik, është mjaft e dendur dhe ka mungesë të strukturave të definuara urbane dhe gjelbërim, pra në përgjithësi mungon hapësira publike, edhe pse kjo zonë ka një sipërfaqe të konsiderueshme të bulevardit Nënë Tereza, Sheshi Ibrahim Rugova dhe Sheshi Skënderbe.



Prezantimi i problemeve nga ana e DUNMM-së



Përfaqësuesit e departamentit të planifikimit në MMPH

Më së shumti u diskutua rreth pjesës veri-perëndimore të planit, saktësisht përmbajtjet biznesore në rrugën "UCK" dhe "Luan Haradinaj", ku gjenden parcela shumë të vogla dhe sipas pronarëve nuk e kanë më interes bashkimin e këtyre parcelave ngase nuk është me e lavërdishme ekonomikisht se sa që është tani në gjendjen ekzistuese. Pra, në këtë zonë u sugjerua të bëhet një regjenerim urban i zonës më pare se sa implementimi i PRRU-së ngase kjo sjellë shume implikime buxhetore gjë për të cilën komuna nuk është e gatshme, sipas banorëve.



Puna në grupe gjate punëtorisë të organizaur për Qendra 1 dhe 2



Prezantimi i problemve nga ana e qytetarëve

Iu dha theks i veçantë "xhepave" të parkimit të cilat gjenden në zonë dhe që kjo po sjellë shumë vetura dhe përpos trotuareve në të gjithë zonës duke pamundësuar lëvizjen normale në trotuare dhe rrugë. Nga kjo doli si rekomandim që do të ishte e udhës që në zonë të krijohet në garazhe e madhe publike e cila do të akomodonte nevojat e banorëve, bizneseve dhe administratës që gjendet në këtë zonë. Edhe menaxhimi i mbeturinave u pa si një sfide në vete edhe pse kjo zonë është në qendër të qytetit.

U diskutua edhe për përmbajtjet kulturore dhe u theksua që në zonën e PRRU-së ka qenë e vendosur shkolla e parë e muzikës në Prishtinë pas luftës së dytë botërore, në vitet e 40-ta. Kjo shkollë duhet të përfshihet në këtë lokacion, si dhe të krijohen hapësira tjera për përmbajtje kulturore, pasi që këto hapësira duhet ta karakterizojnë qendrën e qytetit, si dhe respektimi i trashëgimisë kulturore dhe memories kolektive u kërkua nga banorët.

Edhe pse zona e PRRU-së "Qendra 2" është kryesisht pronë publike dhe nuk është diskutuar shumë për të, gjatë punëtorisë pati edhe përfaqësues të banorëve të cilët paraqitën kërkesat e tyre për ndonjë zgjidhje për një banim më të denjë, pasi që barakat në zonën universitare nuk ofrojnë as kishte minimale për banim.

Në detaje prezantimet e punës grupore dhe kërkesat individuale janë paraqitur në Aneksin 4.

Tophane

Sfondi

Plani Rregullues Urban për "Tophane" është aprovuar më 2005 dhe nga ajo kohë dy herë është plotësuar/ndryshuar me vendimin e asamblesë komunale. Që nga aprovimi i tij në herën e parë Nr. I lejeve të ndërtimit ka qenë 20, janë refuzuar 50 kërkesa dhe janë në procedurë 5 kërkesa për leje të ndërtimit, sipas DUNMM-së. Edhe pse të ftuar disa herë, zona e Tophanes nuk ka qenë e përfaqësuar nga kryetarët e bashkësive lokale dhe nuk është diskutuar shumë për sfidat e implementimit gjatë takimeve me GKK-në, mirëpo përzgjidhja e palëve të interesit është bërë me kujdes dhe u arrit që në punëtorinë për diskutimin e sfidave të marrin pjesë afro 50 pjesëmarrës.

Sipas anketës së realizuar në terren pozitivisht iu kanë përgjigjur 231 qytetarë të zonës dhe nga kjo ka rrjedhur që vetëm 5% të qytetarëve të zonës kanë qenë të informuar gjatë kohës kur është hartuar plani, ndërsa 16% janë në dijeni që një PRRU ekziston për këtë zonë.

Rezultatet e pjesëmarrjes

Punëtorja për PRRU Tophane u mbajt më 24 qershor në shkollën fillore "Meto Bajraktari" në lagjen Tophane. Të pranishëm ishin 46 palë të ndryshme të interesit, si dhe grupi i fasilitatorëve dhe profesionistëve të projektimit.

Sa i përket realizimit të planit në blloqe të planifikuara disa nga qytetarët pjesëmarrës ishin përkrahës të planit për ndërtim kolektiv në lagje, kurse disa të tjerëve iu konvenonte më shumë ndërtimi individual. Banorët e interesuar për ndërtim kolektiv kërkonin që procesi të analizohet mirë dhe të menaxhohet në mënyrë të duhur nga ana e komunës (shih prezantimet grupore dhe anekset e bashkangjitura aneksi 5), përderisa rastet pro ndërtimit individual ishin pronarë që kanë ndërtuar shtëpi individuale në dhjetë vitet e fundit dhe nuk iu konvenon rrënimi i tyre. Sa i përket koeficientit të ndërtimit, banorët ishin të interesuar që ky koeficient të mos zvogëlohet, pra të mbetet siç e parasheh PRRU-ja.



Puna në grupe gjate punëtorisë të organizaur për Tophane



Diskutimi I problemeve me përfaqësuesit të DUNMM-së

Gjithashtu, u diskutua rreth problemit të parkingjeve, atyre joformale si dhe parkingjeve të pamjaftueshme për ndërtimet e larta, si rezultat i ndërtimit pa infrastrukturë përcjellëse. U sugjerua që të kushtëzohen investitorët e këtyre ndërtimeve që të realizojnë parkingje nëntokësore.

Ndërkohë, mungesa e hapësirave të gjelbëruara ishte çështje e adresuar nga të gjithë banorët. Në këtë drejtim u propozua të parashihet një park qendror për të gjithë lagjen në vend të blloqeve me gjelbërim të ndarë siç është paraparë në planin rregullues. Gjithashtu u fol edhe për mungesën e çerdheve publike, hapësirave kulturore dhe sportive, si dhe për shtyllat e stërvjetëruar të energjisë elektrike. Për këto të fundit u kërkua intervenim sa më i shpejtë për shkak të rrezikut që paraqitet për banorët e lagjes. Mungesa e ndriçimit rrugor u adresua me shqetësim të theksuar për shkak të sigurisë së përgjithshme në lagje.



Puna në grupe gjatë punëtorisë të organizuar për Tophane



Prezantimi i problemeve nga ana e qytetarëve

Kërkesë tjetër ishte edhe realizimi i infrastrukturës teknike për tu lidhur me sistemin e ngrohjes qendrore të qytetit. Më tutje u përmend problemi i mbeturinave të hedhura gjithandej nëpër lagje, si dhe hekurishtja në parcelën 4685-0 (përballë xhamisë). Sipas banorëve të lagjes kjo deponi shkakton shumë probleme mjedisore për shkak të ndotjes së ajrit, si dhe insekteve dhe brejtësve të ndryshëm andaj u kërkua zgjidhje urgjente e këtij problem.

Për të gjitha çështjet e adresuara në punë grupore dhe individualisht nga qytetarët referojuni aneksit 5.

Foto nga takimet me GKK-në



Foto nga prezantimi i rezultateve te hulumtimit para GKK-së



DEBAT PËR PLANIN RREGULLUES URBAN EKZISTUES PËR LAGJEN "PRISHTINA E RE – ZONA PERËNDIMI"

Plani rregullues për "Prishtinën e Re" – i dështuar

vijon nga ballina e metros

"Momentin që do t'i kemi të gatshme hartat zonale, do të nisim me procesin e rishikimit të planeve rregulluese", ka thënë Krasniqi për të zënë ngoje edhe mungesën e hapësirave publike për ndërtim të infrastrukturës, pasi që shumë prej tyre janë tjetërsuar, problemet e ri-parcializimit të pronave, sh-pronësimin, etj.

Ndërkaq, Rudina Qerimi, koordinatore e Projektit për 5 planet rregulluese për të cilat komuna ka konsideruar se janë problemore, sidomos pas kërkesave që i kanë bërë banorët, ka theksuar për gazetën se Komuna i ka kërkuar USAID-it që dikush të ndërmjetësojë që të koordinohen punët në këto 5 lagje, përfshirë edhe atë të "Prishtinës së Re", në mënyrë që atyre t'u jepet udhë e mbarë urbane e në pajtim me kërkesat e banorëve. Ajo ka theksuar se "Prishtina e Re" është lagjia më problemore, teksa ka shtuar se pas saj vijnë edhe "Mati 1", "Qendra 1", "Tophanja" e "Pejtoni". Edhe kjo, pas një ankete të bërë me banorët e lagjes, ka nxjerr në pah se "Prishtina e Re – Perëndimi" është në disharmoni të plotë me profilin urban.

Sipas saj, me ligj është e paraparë që planet rregulluese zgjasin 5 vjet, porse për shkak të kërkesave të banorëve ajo mund të rishikohet edhe më herët. Kjo, sipas saj, nëse për një gjë të tillë shpreh interesim edhe Komuna.

"Fakti që Komuna e Prishtinës e ka hedhur këtë plan në diskutim publik, ende pa u bërë dy vjet të plota të miratimit nënkupton se ajo është e interesuar që ta rishikojë në Kuvendin Komunal për rishikim, pasi të jenë ndjekur të gjitha proce-



durat e tjera", ka thënë Qerimi.

Banori i lagjes, Xhavit Kuçi, ndërkaq, ka theksuar se banorët janë ata që i kanë bërë të gjitha investimet infrastrukturorë në lagje, kurse Komuna e Prishtinës nuk e ka asnjë mirëkuptim për këtë çështje, kurse ka miratuar plan për shkatërrimin e asaj infrastrukture nga zyrtar.

Ai dhe shumica e banorëve të pranishëm janë shprehur kate-

gorikisht kundër ndërtimit të unazës së jashtme, e cila po ashtu, është në Planin rregullues, ndërsa do të shkatërronte së koti pronat dhe objektet private të banimit individual apo edhe të biznesit. Ai gjithashtu është ankuar edhe për çmimin e lartë të legalizimit të objekteve të ndërtuara pa leje.

"Infrastruktura rrugore dhe infrastruktura tjetër është dashur të ndërtoheshin nga Komuna, por

meqë ajo që është bërë kryesisht nga privatët, atëherë ajo do të duhej të zbriste koston e legalizimit të objekteve për metër katror.

"Derisa Komuna e Prishtinës e parasheh metrin katror nga 12 – 20 euro, Komuna e Graçanicës e llogarit për legalizim një metër katror vetëm 3 euro", ka thënë ai, teksa ka përmendur dhjetëra probleme që ai dhe banorët e tjerë të lagjes i kanë pasur dhe vazhdojnë t'i kenë ende.

Ky ka kritikuar edhe pushtetin aktual, i cili sipas tij, ka bllokuar gjithçka sa i përket fushës së ndërtimit. Pas një punëtorie në të cilën qytetarët janë ndarë në grupe dhe i kanë fokusuar problemet, Valon Ramabaja, përfaqësues i një grupi ka thënë se situata është krejt jonnormale, se nuk duan ndërtim të lartë, se duan lidhje rrugore e jo rrugë pa krye si deri tash, se infrastruktura teknike është e dobët, se duan ngrohje qendrore etj. Po ashtu ka kërkuar që me rishikimin e Planit të ri rregullues të shikohet puna e uzurpimeve.

"Para lufte ne banorët më të vjetër vetë nuk kemi lejuar uzurpimin e pronave, kurse pas lufte ka ndodhur tjetërsim i madh i pronave", ka thënë ai. Naim Huruglica, po ashtu, banor i lagjes ka kërkuar infrastrukturë që e bën lagjen të hapur. Edhe ky dhe grupi i tij janë shprehur në favor të rishikimit të Planit rregullues. Si edhe të tjerët është shprehur kundër unazës së jashtme që parasheh rrethim shtëpish. Driton Tafallari, përfaqësues i një grupi tjetër qytetarësh, ka kërkuar që të hiqet praktika e bërjes së planeve rregulluese nga zyrtar.

"Ne kemi nevojë për infrastrukturë reale që është në interes të banorëve dhe jo plane futuristike – urbane që s'i hyjnë në punë askujt", ka thënë ai. Po ashtu ka thënë se komuna duhet t'i rregullojë vetë procedurat kur banorët japin pronat private për interes publik. Pothuajse të gjithë diskutuesit janë shprehur në favor të rishikimit sa më të shpejtë të planit rregullues "Prishtina e Re", pasi që sipas tyre, ai është shkatërrues i pronave private, nuk paraqet zgjidhje për shkollat, ambulancat, çerdhe etj.

© KOHA Ditore

Vijon nga ballina e metros

DEBAT PËR PLANIN RREGULLUES

Banorët e lagjes “Mati 1” kërkojnë ndalimin e degradimit urban

vijon nga ballina e metros

Kryetari i Bashkësisë Lokale, Ismet Haziri, ndërkaq, sikur ka dashur t'i ruajë strukturat vendore nga kritikrat për shkatërrimin urban të kësaj lagjeje. Kjo për faktin se, sipas tij, menjëherë pas lufte kjo hapësirë ka qenë e lirë, kurse me administrimin e Komunave nga UNMIK-u nuk ka ekzistuar as interesim e as vullnet për ta bërë një lagje me standarde evropiane. “Ka pasur mundësi të ishte një lagje e mirë, por është lejuar që të bëhet një lagje pa infrastrukturë rruqore e sociale. Sa i përket infrastrukturës rruqore, ai ka theksuar se pos rrugës “Enver Maloku”, e cila është e gjërë dhe i plotëson kushtet urbane, të gjitha të tjerat janë të ngushta dhe që duan ndërhyrje komunale”, ka theksuar tutje Haziri, i bindur se me planin e ri do të mund të rregullohet shumëçka. Nderkaq për infrastrukturën sociale ai tregon se nuk ka shkollë, nuk ka qendër të mjekësisë familjare, nuk ka çerdhe fëmijësh, është pa ndriçim publik, pa trotuare, pa parqe e gjelbërim, pa kënde fëmijësh, pa trafik të organizuar urban etj. “Nxënësit e lagjes shkojnë nëpër shkollë të ndryshme të kryeqytetit duke paguar kombibus nga xhepat e tyre, që është një ngarkesë e madhe”,

ka theksuar ai, duke zënë ngoje edhe plot probleme të tjera. Haziri ka bërë me dije se i ka kërkuar Komunës që me planin e ri rregullues të ketë parasysh investitorët, të cilët nuk i dëmtojnë parcelat e tokave dhe të cilët e kanë respektuar edhe ligjin. Krejt në fund, Haziri ka treguar se mundësitë për ndërtimin e një lagjeje urbane janë shumë të mëdha. Kjo sepse, siç është shprehur ai, hapësira e pandërtuar e lagjes aktualisht është 60 për qind, derisa 40 për qind është përfunduar tashmë. As kryetari i Bashkësisë Lokale e as zyrtarët komunalë nuk kanë shifra të sakta se sa ndërtime pa leje janë të ndërtuara në këtë lagje, por, sipas të dhënave të tyre, në vitin 2014 për ndërtime të larta janë dhënë 6 leje, 14 janë refuzuar, kurse 22 kanë qenë në procedurë. Në vitin 2015 janë lëshuar 5 leje për ndërtime të larta, 4 janë refuzuar dhe 26 janë në procedurë. Po kështu, ka treguar se si në lagje, menjëherë pas lufte, në invazionin e përgjithshëm të ndërtimeve janë uzurpuar edhe shumë hapësira publike. Sipas tij, në pjesën verilindore të lagjes në rreth 2 hektarë tokë të komunës janë ndërtuar më shumë se 20 shtëpi. Sidoqoftë këto probleme janë përmendur edhe nga të pranishmit e tjerë. Se planin rregullues janë bërë

pa mund të duhur nga kompania e kontraktuar dhe nga organet komunale e ka sqaruar edhe Rudina Qerimi, koordinatore e projektit për 5 planet rregulluese për të cilat Komuna ka konsideruar se janë probleme, si: “Pristina e Re – perëndimi”, “Mati 1”, “Qendra 1”, “Tophanja” e “Pejtioni”, ka thënë se nga anketa që e ka zhvilluar me qytetarët e lagjes ka rezultuar se shumica e banorëve ose 34.5 për qind nuk kanë degjuar kurrë për planin rregullues, 22 kanë degjuar por nuk dinë më shumë për të, 25 për qind as që e dinë se për çka është fjala etj. Gjithnjë sipas Qerimit, anketa ka treguar se 3 për qind kanë qenë të njoftuar për planin, 99,5 për qind nuk janë në dijeni për të, kurse vetëm 2 për qind kanë njohuri për planin. Si ndër problemet themelore nga anketa kanë rezultuar planifikimet e papërshtatshme, rrugët e paasfaltuara, mbipopullimi etj. Në këtë takim grupe të ndryshme qytetare, duke pasur përpara planin rregullues në fuqi kanë provuar t'i nxjerrin të gjitha vërejtjet, t'i japin propozimet, në mënyrë që plani i ri të jetë në pajtim me kërkesat qytetare.

© KOHA Ditore



Plani rregullues urban për zonën “Mati 1” është bërë në mars të vitit 2010. Ai mund të rishikohet sivjet, pasi që afatet e planeve të këtilla zakonisht bëhen për 5 vjet. Plani rregullues “Mati 1” është ndër planet më të përfolura nga qeverisja aktuale, e cila pas marrjes së pushtetit më 2013 ka identifikuar probleme vështirë të përmirësueshme dhe me kosto të lartë

NË DITËN E FUNDIT TË AFATIT LIGJOR RISHIKOHET BUXHETI

Riorientohet 6 për qind e buxhetit komunal

administratës dhe personelit, ku janë

Foto nga hulumtimet ne terren



Aneksi 1

Prishtina e Re – Rezultatet e Punëtorisë

Prezentimi Grupi 1

Problemet:

- Uzurpimi i pronave komunale - Kjo ka pamundësuar zhvillimin e infrastrukturës sociale (te identifikohen dhe te mbrohen)
- Riparcelimi - Nuk përputhet me gjendjen ekzistuese
- Destinimi i planifikuar nuk paraqet vullnetin e pronareve (Prone Private)
- Rrugët e planifikuara te perealizueshme (Tereni, Pronësia)
- Infrastruktura teknike ë perealizueshme (Nuk është respektuar gjendja ekzistuese)

Prezantimi Grupi 2

Problemet:

- Ndryshimi i destinimit te sipërfaqes (Prona Private – Shërbime Publike)
- Riparcelizimi rrugët e planifikuara nuk korrespondojnë me rruge ekzistuese

Prioritet

- Riparcelimi – Ndryshim i destinimit
- Propozim vendim i Asamblesë Komunale për ndryshim te PRRU Prishtina ë Re
- Te behet Zhblokimi sa me i shpejte i pronave dhe te na mundësohet dhënia ë lejeve për ndërtim individual
- Ne PRRU fare nuk figurojnë parcelat ndonëse te gjitha shtëpitë ndërtuara kanë leje ndërtimi dhe i kane paguar te gjitha taksat ë parapara me ligje. Deri me tani janë ndërtuar 15 shtëpi qe kane leje ndërtimi
- Ne PRRU parakushtet te kalojnë rrugët dytësore nëpër shtëpitë qe janë ndërtuar me leje ndërtimi, ndonëse është hapësira për rruge qe kufizohet me parcelën e fundit (416/6 – Behxhet Shala Pronar) dhe (415/21 – Drita Berisha Pronare)
- Nuk është bere parcelizimi ne këtë PRRU ndonëse është bere ndarja kadastrale

Prezentimi Grupi 3

Problemet:

- Rruga ekzistuese Mehmet Gjevori, Lokacioni nga pas Gorenjes e deri tek Rruga e Gjilanit "Astra Design" është eliminuar nga PRru – Ekzistuese.
- Nga udhëkryqi Mehmet Gjevori (Fam. Hoti) deri tek lagjja 038 rruga nga plani kalon diagonal
- Nga ura e Gjilanit deri tek "Astra Design" gjelbërimi mbrojtjes nuk përfill gjendjen ekzistuese
- Unaza e Jashtme
- Asfaltimi i rrugëve
- Shkolle, Ambulancë, Çerdhe
- Banim Kolektiv – Ura ë Gjilanit deri tek Baumarket
- Parcela Fortesa
- Largpërçuesi

Prezentimi Grupi 4

Problemet:

- Plani Rregullues Urban
 - Te behet rishikim i PRru-se ekzistues duke ë marre parasysht gjendjen ekzistuese. Ne veqanti pjesa ku është planifikuar ndërtimi i larte
- Infrastruktura Rrugore
 - Te rishikohet shiriti gjelbërues përgjatë rrugës afër "Gorenje-s" (aty gjenden shume objekte qe e pamundësojnë realizimin e këtij brezi)
 - Rrugët ekzistuese te cilat nuk janë ne pajtim me PRrU, te shtrohen me kubëza përfshire edhe infrastrukturën përcjellëse
 - Ne rastet kur pranohet dakordohen te falin trollin për qellim te realizimit te interesit te përgjithshëm (rruga,...). Komuna te merr përsipër obligimet, shpenzimet administrative.
- Transparenca
 - Te përmirësohet komunikimi ne mes te banoreve dhe komunës.
 - Te bëhen vizita me te shpeshta ne teren
 - Te bëhen informimi me kohe dhe adekuat, banoreve lidhur me hartimin ë planeve dhe realizimin e tyre
- Infrastruktura Sociale
 - Te rishikohet Plani ne zonat e destinimit publik ne raport me gjendjen faktike, përkitazi me:
 - ◆ Pronësia
 - ◆ Disponueshmëria hapësirave ne teren (ne disa raste, ne zonat ë planifikuara për infrastrukture sociale ka ndërtime)

Prioritet

Problemet:

- Banim individual
- Te respektohen rrugët ekzistuese
- Te ndryshohet destinimi nga ekzistuese ne te mëparshme

Vërejtje:

Ne planet e propozuara ka shume objekte qe nuk kërkojnë me realitetin.

- Mbi shtëpitë me leje urbanistike kalojnë rrugët
- Ne lagjen për banim individual janë planifikuar objekte si: ambulance, çerdhe
- Trojet janë te regjistruara ne Kadastër

Parcializimi –

- Gjendja ekzistuese e parcelave
- Mungesa e pronave Komunale / Kosto e lartë e shpenzimit

Sfidat:

- Ndryshimi i planit rregullues / çdo 5 vite
- Parcelizimi (110 kë kablllo) (2013-2018)
- Hapësirat Publike dhe Rekreative
- Lidhje e mire me rrugët magjistrale
- Hapësira me QKUK

Kontributi i banoreve:

- Rruga
- Trotuaret
- Hapësirat e Gjellëria
- Infrastruktura rrugore

Rekomandimet:

1. Rrugët

- Rruga pranë Gorenjes parapare që të këtë shirit përcjellës (Gabarit), gjelbërim shumë me të gjere.
- Banoret kërkojnë rishikimin të planit. Kjo vlen edhe për disa rruge të tjera. Të konsultohen banoret duke e marrë parasysh gjendjen ekzistuese.
- Të mos behet asnjë Projekt/Plan pa konsultim të sinqertë me të gjithë banoret.
- Banoret janë shumë konfuz lidhur me planet ekzistuese
- Ka paqartësi të mëdha lidhur me çështjen ekzistuese e kompensimit të trojeve
- Të gjitha rrugët ekzistuese të shtrohen. Të mos mbetet asnjë rrugë me balte. Rrugët të cilat nuk janë me Plan Urban, të ndërtohen me kubëza. Këtu të përfshihet edhe infrastruktura përcjellëse (kanalizimi, ndriçimi, ujë, rryme).
- Pas parcelizimit të trojeve, shumë rrugë kanë mbete në pronësi të pronarit të parë. Kërkohej ndërmjetësim i Komunës.

2. Plani Urban

- Të fillohet iniciativa për ndryshimin e Planit Urban. Patjetër të merret parasysh gjendja ekzistuese.
- Zona e planifikuar për ndërtim të lartë (Banim Kolektiv) të rishqyrtohet sipas gjendjes praktike dhe në konsultim me banorë.

3. Transparenca

- Të përmirësohet komunikimi në mes të banoreve dhe komunës (shembull: ka rrjedhje të kanalizimit në rruga e Shkupit në disa muaj dhe nuk ka adresim adekuat; Ura afër Spitalit Amerikan është e dëmtuar dhe paraqet rrezik permanent).
- Ka banorë të cilët nuk kanë qasje fare në rrugë. Kërkohej ndihma e Komunës.

4. Infrastruktura Sociale

Të rishqyrtohet plani në zonat e planifikuara të destinimit publik në raport me gjendjen faktike.

Sa i përket:

- Pronësisë
- Disponueshmërisë së hapësirave (Nëse ato janë të lira apo nëse aty veç ka ndërtime ekzistuese)

Prezentimi Grupi 5

Grupi 5 (a)

- 1.1. Zonat brenda lagjes te destinuarra për banim afarizëm te kthehen ne banim individual
- 2.1 Rrugët sipas PRru kalojnë ne prona private rezidenciale
- 2.2 Unaza e 3-te te anulohet
 - Autostrada
 - Shpronësimi ka kosto te larte
- 3.1 Zhvendosja e shkollës?
 - Autostrada afër 50 m
 - Pronësia Private e Trojeve
- Çerdhja
 - Pronësia Private e Trojeve
- Qendra Rekreative
 - Pronësia Private e Trojeve
- Zonat e Biznesit
 - E vetmja pike ku pajtohem

Grupi 5 (b)

1. Ri projektimi i Planit Rregullues Urban
2. Ndërtimi i Infrastrukturës Rrugore
3. Mungesa ë objekteve Publike
4. Përmirësim te gjendjes Sociale
5. Dëmtimi i objekteve afariste

Problemet

Problemet: Te **Grupit 5a**

Problemet e lagjes prej udhëkryqit të rrugës së Prishtinës – Gjilan në drejtim të fshatit ndërkombëtarë e mbrapa të ish hotel Madridi.

1. Në këtë pjesë sipërfaqja tokësore është e destinuar për banim individual. Projektimi i unazës dhe i gjelbërimit është problem serioz për banoret, sepse kjo ndryshon destinimin e sipërfaqeve tokësore nga ato për banim për zona gjelbërimi dhe krijimi i rrugëve. Projektimi i unazës së bashku me gjelbërim kalon nëpër Restorant Puro që gjendet në parcelën Kadastrale Nr.439/1 dhe 439/8 edhe pse përball kësaj parcele private gjendet parcela Komunale për çudi rruga është projektuar të kalojë nëpër pronë private. Kjo ndikon direkt në rritjen e kostos së shpenzimit.
2. Infrastruktura rrugore mungon tërësisht këtë lagje. Ka mundësi të kanalizimit, ndriçimit, trotuares etj.
3. Në këtë lagje nuk ka qasje objekt publik është tërësisht e anashkaluar kjo lagje Kuvendi Komunal i Prishtinës. Nuk ka shkolle, çerdhe (kopsht) për fëmijë, qendër të mjekësisë familjare etj.
4. Popullata e kësaj lagjeje i takon shtresës me të ulët të B.L. Nr.5 dhe jetësimi i planit PRru Prishtina e Re do të rëndonte tej mase gjendjen e këtyre banoreve.
5. Në rast mos ndryshimi të këtij plani në këtë lagje do të dëmtoheshin edhe ato pak biznese afariste sepse sipas planit parashihet rrënim i këtyre objekteve si psh. Restorant Puro, Genc Roll, Qendra Evropiane për arsim profesional etj.

Problemet: Te **Grupit 5b**

